



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0658

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 08. 09. 2023, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anltare, duke vendosur sipas ankesës së OE “NNT Bini” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III” me numër të prokurimit VU644-23-2787-5-1-1, të Komunës së Vushtrrisë në cilësi të autoritetit kontraktues (AK) –më 07/11/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e NNT “Bini” SH.P.K. me nr. 2023/0658, e datës 05/09/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III”, me numër të prokurimit VU644-23-2787-5-1-1, të Komunës së Vushtrrisë në cilësi të autoritetit kontraktues (AK).
2. Mbetët në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për aktivitetin e sipërcituar.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 03.04.2023, Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III” me nr. të prokurimit: VU644-23-2787-5-1-1.

Me 29. 08. 2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar OE “Alfa.I”.

OE “NNT Bini” SH.P.K. me datën 01.09.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 04. 09. 2023, AK - Komuna e Vushtrrisë me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të

OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "NNT Bini" SH.P.K., me datën 05.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0658, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim

Përgjigja e parë (I): Autoriteti Kontraktues, pasi që i shqyrtoj një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazuar në tërësinë e saj, për arsye se: Marrëveshjen për pagesën e borxheve tatimore me këste në ATK Nr. 19672 e dt. 31.05.2023, në emër të OE-ve Tatimpaguesit "Toifor" sh.p.k., si anëtar i Grupit të OE-ve, rezulton se ju nuk keni përmbushur Kërkesat e Pranueshmërisë, në kuptim të nenit 65 paragrafi 5 të LPP-së, që ndërlidhet me periudhën kohore kur OE duhet të jetë i pranueshëm, që nënkupton se një O.E. duhet të jetë gjithmonë i pranueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 65 paragrafi 5 të LPP-së para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. Në bazë të të dhënave nga aktiviteti i prokurimit në fjalë rezulton se Njoftimi për Kontratë, në platformën elektronike është publikuar me dt. 03.04.2023, ndërsa Marrëveshja për pagesë të borxheve tatimore me këste, ATK Nr. 19672 në emër të anëtarit të Grupit të OE-s "Toifor sh.p.k. është lidhur me dt.31.05.2023. Rrjedhimisht, bazuar dhe në interpretimin e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik nr. 64 dt. 17.04.2019, më tej KRPP, citojmë interpretimin "Nisur nga fakti se shumë O.E. kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve në ATK-në, KRPP sqaron se edhe në rastin konkret, marrëveshja për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë" mbarim i citatit, që në rastin konkret Marrëveshja e OE është lidhur pas datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë, ku OE „Toifor“ sh.p.k. është vlerësuar si i papranueshëm dhe tenderi i Grupit të OE-ve në fjalë si papërgjegjshëm, sepse rrjedhimisht dokumentin si të tillë e bën jo të rregullt, të papranueshëm dhe në kundërshtim me interpretimin e KRPP-së, ndërsa OE e vlerëson si OE të papranueshme, respektivisht të papërgjegjshme, pasi që nuk i përmbushë Kërkesat e Pranueshmërisë së Përshtatshmërisë, në kuptim të nenit 65 paragrafi 5 të LPP-së, që ndërlidhet me periudhën kohore kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve të vendosë për dhënie të kontratës OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Mbi këtë bazë AK vlerëson se Vendimi i AK i dt. 29.08.2023 është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së. Vendimi, sikurse ka vlerësuar AK, është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar,

që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “NNT Bini” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi* Me dt 30.08.2023 përmes platformës e-prokurimi, kemi pranuar dokumentin: Njoftim mbi vendimin e AK, ku Grupi i OE “NNT Bini” Shpk & “Toifor” Shpk shpallen të papërgjegjshëm. Bazuar në faktet e cekura në njoftimin në fjale, ju si AK keni shkelur dispozitat dhe normat ligjore të KRPP, LPP, Rregullat dhe udhëzuesi publik i prokurimit publik, rregulloren 001/2022, pasi që ju si AK nuk i jeni përmbajtur as kërkesave tuaja të cekura në DT dhe në kërkesat për dokumente shtese gjate zhvillimit të procedurës së prokurimit. Me deklaratën e cekur në Njoftimin mbi vendimin e AK të dt 29.08.2023 (shpallur në platforme më 30.08.2023) ju keni rënë në kundërshtim me kërkesat për dokumente shtese të dt 17.08.2023 ku nder të tjerash keni kërkuar: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonese për pagimin e tatimeve ky vërtetim duhet të jete jo më i vjetër se 90 dite kalendarike nga data e hapjes së këtij aktiviteti, duhet të dorëzohet në kopje pra, bazuar në kërkesën tuaj të lartcekur, ju keni kufizuar vetëm vjetërsinë e dokumentit kurse nuk ndalon që i njëjti të mund të nxirret pas datës së hapjes. Sipas jush partneri i grupit, gjegjësisht OE “Toifor” SHPK është i papranueshëm sepse është me vonese në pagesën e tatimeve. Në konsiderojmë se fakti për të cilin jemi eliminuar nuk qëndron pasi që partneri i grupit gjegjësisht “Toifor” SHPK është në marrëveshje dhe është duke iu përmbajtur marrëveshjes për shlyerjen e borxheve gjë që ju kemi dëshmuar në dokumentet e ngarkuara në platformën E-Prokurimi. Bashkëngjitur gjeni kërkesat nga AK dhe dëshmitë e dërguara nga ne si Grup i OE. Andaj arsyet dhe faktet e paraqitura më lartë, dhe për shkak që mos të dëmtohet interesi publik nga mungesa e marrjes së shërbimeve me kohë, dhe në anën tjetër që të ndalet dhe parandalohet dëmi serioz që është shkaktuar në drejtim të parashtruesit të ankesës duke ia mohuar të drejtën ligjore që të shpërblehet me kontratë pasi nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe, kërkojë që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura AK – Komuna e Vushtrrisë.

Eksperti shqyrtues me datën 22.09.2023 ka dorëzuar raportin e ekspertizës duke rekomanduar që: *“ankesa të refuzohet si e pabazuar, të mbetet në fuqi vendimi i AK-së”*. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të gjitha palët procedurale. AK lidhur me mendimin e ekspertit ka deklaruar se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me tutje, lidhur me pretendimet e OE “NNT Bini SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0658 ka vlerësuar si në vijim:

- Pretendimi i parë (I):* OE ankues pretendon se: “Me dt 30.08.2023 përmes platformës e-prokurimi, kemi pranuar dokumentin: Njoftim mbi vendimin e AK, ku Grupi i OE “NNT Bini SHPK & Toifor” SHPK shpallen te papërgjegjshëm. Bazuar ne faktet e cekura ne njoftimin ne fjale, ju si AK keni shkelur dispozitat dhe normat ligjore te KRPP, LPP, Rregullat dhe udhëzuesi publik i prokurimit publik, rregulloren 001/2022, pasiqe ju si AK nuk i jeni përmbajtur as kërkesave tuaja te cekura ne DT dhe ne kërkesat për dokumente shtese gjate zhvillimit te procedurës se prokurimit. Me deklaratën e cekur ne Njoftimin mbi vendimin e AK te dt 29.08.2023 (shpallur ne platforme me 30.08.2023) ju keni rene ne kundërshtim me kërkesat për dokumente shtese te dt 17.08.2023 ku nder te tjerash keni kërkuar: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj te themelimit se Ju nuk jeni ne vonese për pagimin e tatimeve ky vërtetim duhet te jete jo me i vjetër se 90 dite kalendarike nga data e hapjes se këtij aktiviteti, duhet te dorëzohet ne kopje Pra, bazuar ne kërkesën tuaj te lartecekur, ju keni kufizuar vetëm vjetërsinë e dokumentit kurse nuk ndalon qe i njëjti te mund te nxirret pas datës se hapjes. Sipas jush partneri i grupit, gjegjësisht OE Toifor SHPK është i papranueshëm sepse është me vonese ne pagesën e tatimeve. Ne konsiderojmë se fakti për te cilin jemi eliminuar nuk qëndron pasiqe partneri i grupit gjegjësisht “Toifor” SHPK është ne marrëveshje dhe është duke iu përmbajtur marrëveshjes për shlyerjen e borxheve gjë qe ju kemi dëshmuar ne dokumentet e ngarkuara ne platformën E-Prokurimi. Bashkëngjitur gjeni kërkesat nga AK dhe dëshmitë e dërguar nga ne si Grup i OE. Andaj arsyet dhe faktet e paraqitura më lartë, dhe për shkak që mos të dëmtohet interesi publik nga mungesa e marrjes së shërbimeve me kohë, dhe në anën tjetër që të ndalet dhe parandalohet dëmi serioz që është shkaktuar në drejtim të parashtruesit të ankesës duke ia mohuar të drejtën ligjore që të shpërblehet me kontratë pasi nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe”. Duke u bazuar në pretendimin e ngritur nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se ekzistojnë disa interpretime të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të cilët tregojnë se si AK duhet të veprojë sa i përket vërtetimit nga ATK se OE nuk ka borxhe tatimore ndaj shtetit. Përkatësisht pika 6 tek Interpretimet e KRRP-së e datës 22/11/2022, në lidhje me pyetjen se- A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?, thotë si në vazhdim: “..Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.” Duke u bazuar në dëshminë e dorëzuar nga anëtari i konzorciumit TOIFOR SHPK- marrëveshja për shlyerje të borxheve e lidhur me ATK, shihet se kjo marrëveshje është lidhur me datë 31/05/2023, pra data e cila figuron në dokument është pas publikimit të njoftimit për kontratë (03/04/2023). Sa i përket pjesës se kërkesës për dokumente shtesë ku OE ankues pretendon se AK ka rënë në kundërshtim me të njëjtat, sepse është kërkuar që vërtetimi të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike, nga data e hapjes së aktivitetit ku sipas OE është kufizuar vetëm vjetërsia por

nuk ndalon që i njëjti mund të nxirret edhe pas datës së hapjes së ofertave, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka mundësi të përcaktoj se deri sa i vjetër mund të jetë dokumenti në mënyrë që të konsiderohet i pranueshëm, ndërsa sa i përket pjesës tjetër kjo rregullohet me Ligjin për Prokurimin Publik si dhe Interpretimin e lëshuar nga KRRP i cili u cek më lartë. Bazuar në LPP dhe interpretimin e dhënë nga KRPP në lidhje me këtë vërtetim, edhe mendimi i ekspertit shqyrtues është se ky pretendim i ngritur nga OE “Bini” SHPK është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Bini” SH.P.K.. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE janë të pabazuara, ngase

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkuara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij aktiviteti të prokurimit, nga pikëpamja e këtij Paneli, janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund ti drejtohet Gjykatës Komerciale Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - NNT BINI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: